



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 5

29 janar

2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr. 1, datë 20.1.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; të vendimit nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	81
Vendim i GJK nr. 2, datë 22.1.2014	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	87
Vendim i GJK nr. 3, datë 23.1.2014	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimeve: nr.752, datë 24.03.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.361, datë 28.09.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.00-2011-792, datë 07.06.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	93
Urdhër i GJK nr. 1, datë 7.1.2014	Për delegim kompetencash.....	100

VENDIM
Nr. 1, datë 20.1.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	Anëtar i	“	“
Fatos Lulo	Anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 10.12.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 50/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Belul Toto, përfaqësuar nga avokat Nevzat Tarelli, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koci.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; i vendimit nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 29/3, 42/2, 131/f, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të mbrojtësit të kërkuesit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 401, datë 11.11.2010, ka vendosur, ndër të tjera:

- deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të “prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (KP), dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim;
- deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të “mosbindjes ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 242 i KP-së, dhe dënimin e tij me 1 muaj burgim;
- në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, dënimin e vetëm me 5 vjet burgim;
- në bazë të nenit 34 të KP-së, dënimin e tij edhe me gjobë në masën 200.000 lekë.

2. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 32, datë 15.3.2011, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes për kërkuesin.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 32, datë 16.3.2011 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, pasi këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:



4.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë respektuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për shkak të vlerësimit të gabuar të provave dhe të çmuarjes së tyre në kundërshtim me atë çka provonin.

4.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë respektuar nenin 142/1 të Kushtetutës, që sanksionon detyrimin e arsyetimit të vendimit, pasi në këto dy vendime nuk arsyetohen provat dhe fuqia e tyre provuese, si dhe nuk rezulton një analizë e plotë e tyre në raport me provat e mbrojtjes.

4.3. Gjykata e Lartë ka gjykuar dhe shpallur fajtor kërkuesin për veprën penale “mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë”, e cila në momentin e gjykimit ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, i hyrë në fuqi në datën 28.12.2012.

4.4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë, në kundërshtim me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese, kanë aplikuar për kërkuesin, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka paraqitur me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

5.1. Pretendimet e kërkuesit për çmim dhe vlerësim provash, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, pasi ato nuk hyjnë në juridiksionin e saj, por kanë të bëjnë me konstatimin e çështjeve që, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, janë në kompetencë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Po ashtu, pretendimi i kërkuesit për paanshmëri të këtyre gjykatave është i pabazuar, sepse nuk është paraqitur asnjë argument për të provuar se gjykatat nuk kanë ofruar garanci procedurale të mjaftueshme dhe se kanë pasur interesa personale në çështjen në shqyrtim.

5.2. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre shpjegojnë dhe arsyetojnë shkaqet e themelit të dhënies së vendimeve të tyre, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, provave të administruara, të cilat janë analizuar në harmoni me njëra-tjetrën, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve në gjykim, duke përmbushur detyrimin e sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.

5.3. Vepra penale “mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë”, për të cilën është dënuar kërkuesi, plotëson kriteret për përfitim nga ligji nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”. Qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që nuk ka vendosur pushimin e çështjes për këtë vepër penale, përbën një ometim. Gjithsesi, ky ometim nuk shkakton një dënim real të kërkuesit, pasi nuk ka ndikuar në masën e dënimit. Gjithashtu, ai është i riparueshëm pasi kërkuesi, sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), mund t’i drejtohet gjykatës në fazën e ekzekutimit. Në këtë drejtim, kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

5.4. Në lidhje me aplikimin e dënimit me gjobë krahas atij me burg, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në përputhje me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka aplikuar ndaj kërkuesit dënimin me gjobë në zbatim të nenit 34/4 të KP-së, pasi vepra “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, është kryer për përfitime materiale dhe fakti që kjo dispozitë përmban vetëm dënim me burgim, lë vend edhe për një dënim me gjobë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin e vlerësimit të provave

6. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë kanë vlerësuar në mënyrë të gabuar provat dhe i kanë çmuar ato në kundërshtim me atë çka provonin. Gjithashtu, në vendimet e tyre, këto gjykata nuk kanë arsyetuar mbi fuqinë provuese të provave dhe nuk kanë bërë një analizë të plotë të tyre në raport me provat e mbrojtjes. Për rrjedhojë, sipas kërkuesit, është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, si dhe parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.

7. Gjykata vlerëson se, pavarësisht mënyrës së formulimit të pretendimeve të kërkuarit, në thelb, ato kanë të bëjnë me çështje të konstatimit dhe vlerësimit të provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur, në mënyrë të vazhdueshme, se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes janë në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor të cilat nuk mund të jenë objekt i gjykimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Gjykata nuk mund të bëjë vlerësim të provave dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Si pasojë, Gjykata çmon se ajo nuk mund të investohet për shqyrtimin e pretendimeve të kërkuarit si më sipër, përderisa ato nuk janë ngritur në nivelin e një gjykimi kushtetues.

Për pretendimin e amnistisë së veprës penale

9. Kërkuari pretendon se Gjykata e Lartë e ka gjykuar dhe shpallur fajtor për veprën penale “mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të policisë”, e cila në momentin e gjykimit ishte amnistuar me ligjin nr. 107/2012, i hyrë në fuqi në datën 28.12.2012. Edhe subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, parashtron se kjo veprë penale plotëson kriteret për përfitim nga ligji i lartpërmendur për dhënien e amnistisë dhe se qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që nuk ka vendosur pushimin e çështjes për këtë veprë penale, përbën thjesht një ometim të tij.

10. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar pretendon se kërkuari nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore të ankimit, si kusht për t’iu drejtuar Gjykatës, pasi ai, për të riparuar ometimin e Gjykatës së Lartë, konform nenit 480 të KPP-së, mund t’i drejtohet gjykatës kompetente në fazën e ekzekutimit të vendimit.

11. Në titullin IX, kreu II, i KPP-së, parashikohet shqyrtimi nga gjykata i çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve. Në këtë kontekst, neni 480 i KPP-së sanksion kompetencat e tjera të gjykatës në fazën e ekzekutimit, të tilla si: shuarja e veprës penale pas dënimit, shuarja e dënimit etj. Referuar kapitullit të KPP-së, në të cilin gjendet neni 480, dhe mbështetur në përmbajtjen e tij, Gjykata vlerëson se ky nen ka të bëjë ekskluzivisht me kompetencat e gjykatave të sistemit gjyqësor në fazën e ekzekutimit të vendimit, ndërsa rasti objekt shqyrtimi është i lidhur ngushtë me pasojat që amnistia e veprës penale sjell në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, ndryshe nga sa prapëson subjekti i interesuar, kërkuari legjitimohet në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate.

12. Në këto kushte, në zbatim të parimit *iura novit curia*, sipas të cilit Gjykata mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura nga kërkuari bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuari (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se çështja që shtrohet për shqyrtim në rastin konkret konsiston në vlerësimin nëse kërkuarit i është cenuar e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29/3 të Kushtetutës.

13. Gjykata është shprehur se ky është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe si i tillë, është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Kjo dispozitë kushtetuese reflektohet edhe në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një veprë që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte veprë penale; ligji i ri që nuk dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese; kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale.



14. Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përrjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen. Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Për më tepër, ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005; nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të parimit të lartpërmendur, nisur edhe nga pretendimet e ngritura nga subjekti i interesuar, vlerëson të rishprehet për kuptimin kushtetues e ligjor të amnistisë, si dhe për pasojat që ajo sjell ndaj procedurave të gjykimin në Gjykatën e Lartë.

16. Amnistia përbën një masë të përgjithshme faljeje për kategori të përcaktuara veprash penale të kryera në një periudhë të caktuar kohe, apo dënimeve përkatëse. Në trajtimin doktrinar penal dhe jurisprudencial të amnistisë, njihen amnistia e veprës penale që vepron para dhënies së vendimit përfundimtar të dënimit me pasojë shuarjen e veprës penale të kryer dhe amnistia e dënimit, e cila ndërhysh pas dhënies së një vendimi përfundimtar dënimi, duke shuar ekzekutimin e dënimit, dhe të dënimeve aksesore, edhe pse mbeten efektet e tjera penale. Ndryshimi midis tyre qëndron në faktin se amnistia e veprës penale sjell si pasojë mosfillimin ose pushimin e ndjekjes penale përpara se të jetë dhënë një vendim përfundimtar dënimi (i ekzekutueshëm), ndërsa amnistia e dënimit sjell efekte pas dhënies së vendimit të ekzekutueshëm (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin konkret, rezulton se ligji nr. 107/2012 "Për dhënie amnistie", datë 8.11.2012, i hyrë në fuqi në datën 28.12.2012, në nenin 5 të tij, ndër kriteret për përfitimin e amnistisë ka parashikuar se "1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar duhet të pushojë për veprat penale të kryera deri në datën 30 shtator 2012, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë. 2. Sipas kompetencës së dhënë nga Kodi i Procedurës Penale dhe në varësi të fazës apo të shkallës së procedimit penal, prokurori ose gjykata vendosin mosfillimin e çështjes penale apo pushimin e çështjes penale për veprat penale që amnistohen".

18. Nga ana tjetër, në nenin 71 të KP-së përcaktohet se: "Me aktin e amnistisë organi kompetent përjashton nga ndjekja penale, nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose bën zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë. Amnistia shtrihet për ato vepra penale të kryera deri një ditë para shpalljes së saj, veç rastit kur në aktin përkatës vendoset ndryshe".

19. Në lidhje me përmbajtjen e kësaj norme, Gjykata ka përcaktuar se akti i amnistisë parashikon disa organe, të cilat, me hyrjen në fuqi të këtij akti (ligji për dhënie amnistie), marrin kompetencë për të përjashtuar nga ndjekja penale (*amnistia e veprës penale*), nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose për të bërë zëvendësimin e dënimit me një lloj dënimi më të butë (*amnistia e dënimit*). Kështu, Prokuroria, që në kuptim të nenit 148/1 të Kushtetutës, është organi që ushtron ndjekjen penale dhe gjykata, që, në kuptim të nenit 42 dhe 135 të Kushtetutës, është organi kompetent që gjykon akuzat e ngritura ndaj individëve për vepra penale, me hyrjen në fuqi të ligjit për amnistinë, autorizohen të përjashtojnë nga ndjekja penale vepra penale të kryera sipas parashikimeve të këtij ligji. Për sa i përket përjashtimit nga vuajtja tërësisht apo pjesërisht e dënimit ose zëvendësimin të tij, organet kompetente janë ato të parashikuara nga ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e dënimeve penale", i ndryshuar (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kodi i Procedurës Penale në disa norma të tij parashikon efektet ligjore që sjell amnistia ndaj procedimit penal dhe ndjekjes penale. Kështu, sipas nenit 290/dh: "Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe nëse ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur është dhënë amnistia"; ndërsa neni 387/1 parashikon se: "Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkaku". Neni 428/1, shkronja "c" parashikon se: "Gjykata e Apelit vendos prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur

janë rastet që nuk lejojnë fillimin apo vazhdimin e procedimit”; ndërsa sipas nenit 442: “1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur: a) vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte. 2. Në rastet e parashikuara nga shkronja “a” Gjykata vendos pushimin e çështjes”.

21. Nga sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se amnistia e veprës penale gjen zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë. Kështu, në rastet kur gjykata e shkallës së parë zbaton amnistinë e veprës penale, ajo ka detyrimin të deklarojë pushimin e çështjes. Nëse amnistia e veprës penale zbatohet në procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë, këto të fundit duhet të prishin vendimet e dhëna nga gjykatat më të ulëta dhe të pushojnë çështjen penale (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se në momentin e shqyrtimit të çështjes (datë 24.4.2013) në Gjykatën e Lartë, ligji nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie” kishte hyrë në fuqi (28.11.2012) dhe se vepra penale “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, për të cilën është dënuar kërkuesi, plotëson kriteret për përfitimin e amnistisë. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka vendosur pushimin e çështjes për këtë vepër penale. Për pasojë, Gjykata çmon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues.

Për pretendimin e aplikimit të dy dënimeve kryesore

23. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Lartë, në kundërshtim me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese, kanë aplikuar për kërkuesin, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë.

24. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendimi i së cilës është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, ka aplikuar dënimin me gjobë ndaj kërkuesit, në zbatim të nenit 34/4 të KP-së, me arsyetimin se vepra penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, për të cilën kërkuesi është shpallur fajtor, është kryer për përfitime materiale dhe dispozita (neni 283/1 i KP-së) përmban vetëm dënim me burgim.

25. Me vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, kjo Gjykatë ka vendosur shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, edhe të nenit 29, paragrafi i fundit të KP-së, duke arsyetuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë, me parashikimet aktuale të KP-së, të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e pjesës së posaçme të KP-së, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të KP-së.

26. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se vlerësimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë në linjë me jurisprudencën e kësaj Gjykate dhe, për pasojë, ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit, për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, janë pjesërisht të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sa i përket të gjykuarit Belul Toto, në pjesën që e konsideron atë fajtor për veprën penale të “mosbindjes ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 242 i KP-së.



- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më datë 10.12.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete vlerësoj se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Belul Toto është haptazi e pabazuar dhe duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata, ndaj çmtoj të shprehem me mendim pakice për arsyet që mbështetin këtë qëndrim timin.

2. Nga rrethanat e kësaj çështjeje rezulton se kërkuesi Belul Toto, me vendimin nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, është deklaruar fajtor për veprën penale të “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, duke u dënuar me 5 vjet burgim, si edhe për veprën penale të “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 242 i KP-së, duke u dënuar me 1 muaj burgim. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, kërkuesi është dënuar me 5 vjet burgim. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Korçë, e cila me vendimin nr. 32, datë 15.3.2011 e ka pushuar çështjen penale në ngarkim të kërkuesit. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 32, datë 16.3.2011 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 401, datë 11.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar, mes të tjerash, se në momentin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë kishte hyrë në fuqi ligji nr. 107, datë 8.11.2012 “Për dhënie amnistie”, dhe se lidhur me veprën penale “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, Kolegji Penal duhej të vendoste pushimin e çështjes. Gjyqtarët në shumicë, me arsyetimin se amnistia e veprës penale gjen zbatim në të gjitha fazat procedurale të procesit penal, me pasojë pushimin e çështjes për ato vepra penale për të cilat ndjekja penale nuk duhet të fillojë ose të vazhdojë, si edhe bazuar në ligjin nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”, kanë vlerësuar se vepra penale “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë”, për të cilën është dënuar kërkuesi, plotëson kriteret për përfitimin e amnistisë dhe se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos vendosur pushimin e çështjes për këtë vepër penale ka cenuar parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues, të sanksionuar në nenin 29/3 të Kushtetutës.

4. Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005, nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Me tej Gjykata ka theksuar se, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se ligji për amnistinë ka hyrë në fuqi në datën 28.12.2012, kohë në të cilën çështja ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe pritej të shqyrtohej nga Kolegji Penal. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në atë gjykatë, datë 24.4.2013, rezulton që kërkuesi të jetë përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, i cili është dëgjuar dhe ka paraqitur të gjitha argumentet ligjore në kundërshtim të pretendimeve të ngritura në rekurs nga prokurori, por nuk rezulton që të ketë kërkuar zbatimin e ligjit për amnistinë në favor të kërkuesit.

6. KPP-ja ka parashikuar rastet në të cilat Gjykata e Lartë vepron edhe kryesisht, siç janë ato të parashikuara në nenin 43 (verifikimet për përgjegjshmërinë e të pandehurit); nenin 71 (pasojat e procedimit civil dhe administrativ për atë penal); nenin 72 (mungesa e juridiksionit); nenin 83 (moskompetenca); nenin 260 (revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit). Duke mos qenë para asnjërit prej këtyre rasteve, Gjykata e Lartë nuk kishte detyrimin që të zbatonte kryesisht ligjin për

amnistinë, në kushtet kur ky pretendim i kërkuesit nuk është ngritur para asaj gjykate. Nëse ky pretendim do të ishte ngritur nga mbrojtësi i kërkuesit, atëherë Gjykata e Lartë do të duhej ta merrte atë në shqyrtim dhe të zbatonte, nëse ishte rasti, dispozitat e ligjit për amnistinë.

7. Megjithatë, Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata nuk ka pasur parasysh se kërkuesi është dënuar për dy vepra penale, atë të “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i KP-së, dhe “mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të policisë”, parashikuar nga neni 242 i KP-së. Për këtë të fundit kërkuesi është dënuar me një muaj burgim, ndërkohë që në përfundim të gjykimit ky dënim është përthithur nga ai i dhënë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për veprën penale të “prodhim dhe shitje e narkotikëve”. Në këto kushte, vendimmarrja e Gjykatës është formale dhe vendimi i saj, edhe pse konstaton cenim të parimeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor, nuk sjell asnjë ndryshim në të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit, të cilat ka për qëllim të mbrojë e drejta për një proces të rregullt ligjor.

8. Karakteri formal i kësaj vendimmarrjeje shfaqet, në mënyrë të qartë, edhe në pjesën urdhëruese të vendimit, në të cilin Gjykata shprehet për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-945 (144), datë 24.4.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vetëm në pjesën që e ka konsideruar kërkuesin fajtor për veprën penale të “mosbindjes ndaj urdhrat të punonjësit të policisë”.

9. Për sa më sipër, mendoj se kërkesa e paraqitur nga Belul Toto, duhej të ishte rrëzuar si e pabazuar.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM
Nr. 2, datë 22.1.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj,	anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datë 19.9.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 19/2 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Enver Korteshi, Estref Avdillari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Rovena Korteshi, Mikel Korteshi, Artur Korteshi, Selvije Korteshi, Mimoza Beqiri (Avdillari), Donika Beqiri (Avdillari), Servete Beqiri (Avdillari), Mit'hat Almanzovali, Fadil Duraku, Zoje Shurdhi, Mustafa Shurdhi, Dylbere Shurdhi, Xhoana Shurdhi, Hava Shurdhi, Artan Binaj, Muhamet Farouk Abdeal, Mohamed Faotuzi, Hekri Elmazi, Shoqëria “Twaik” sh.p.k., këshilli i Qarkut Tiranë, komuna Kashar Tiranë, KKKP Tiranë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi pretendimet e palëve dhe aktet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 798, datë 20.10.1994, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë ka njohur pronar shtetasin Ibrahim Shurdhi, mbi një sipërfaqe truell prej 14.000 m², duke u kthyer trashëgimtarëve të tij (Zoje Shurdhi etj.), në natyrë, sipërfaqen prej 5.000 m² dhe duke vendosur kompensimin për pjesën e mbetur prej 9.000 m². Gjithashtu, me vendimin nr. 55, datë 9.6.1997, KKKP-ja Tiranë ka vendosur t'i kompensojë trashëgimtarët e ish-pronarit Ibrahim Shurdhi për një sipërfaqe prej 4.600 m², brenda sipërfaqes prej 9.000 m².

2. Pas tjetërsimit të pasurisë së mësipërme, në bazë të disa kontratave shitblerjeje dhe dhurimi, pasuria prej 5.000 m² është regjistruar në emër të shtetasve Mit'hat Almanzolavi dhe Fadil Duraku.

3. Këshilli i Rrethit Tiranë, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me aktet e marrjes së tokës në pronësi datë 12.6.1993, dhe datë 15.11.1994, ka pajisur me tokë në pronësi, përkatësisht, shtetasit Estref Avdillari, për sipërfaqen 2.900 m², dhe Enver Korteshi, për sipërfaqen 4.000 m². Një pjesë e kësaj sipërfaqeje toke, prej 2.000 m², i është shitur shtetasës Selvije Rushiti, veprime këto që, gjithashtu, janë pasqyruar në regjistrat e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.

4. Me pretendimin se prona në fjalë ndodhej brenda vijës së verdhë të qytetit të Tiranës dhe, si rrjedhim, ka qenë tokë truell e nuk mund të ndahej në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", shtetasit Mit'hat Almanzolavi dhe Fadil Duraku i janë drejtuar me padi gjykatës, me pretendimin se marrja e tokës në pronësi nga shtetasit Enver Korteshi dhe Estref Avdillari, ka qenë e paligjshme.

5. Shtetasit Enver Korteshi, Estref Avdillari, Selvije Rushiti etj. kanë paraqitur kundërpadi, duke pretenduar pavlefshmërinë e vendimeve të sipërcituara të KKKP-së Tiranë, që kanë disponuar në favor të trashëgimlënësit Ibrahim Shurdhi, për arsye se organi administrativ kishte disponuar mbi një tokë bujqësore të ndarë në përputhje me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe, si rrjedhim, veprimi ishte në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave". Për këtë arsye, kanë kërkuar edhe konstatimin e pavlefshmërisë së të gjitha veprimeve juridike të mëpasshme (kontratave të shitblerjes dhe dhurimit).

6. Me vendimin nr. 672, datë 27.2.2001, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë. Ky vendim është ndryshuar me vendimin nr. 987, datë 19.9.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim.

7. Me vendimin nr. 3064, datë 9.7.2002, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 1120, datë 29.10.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kurse me vendimin nr. 505, datë 4.4.2004, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në po atë gjykatë.

8. Me vendimin nr. 1199, datë 27.10.2004, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe rrëzimin e kundërpadisë, vendim që është prishur sërish, me vendimin nr. 51, datë 19.1.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dhe çështja është dërguar për rishqyrtim në po atë gjykatë.

9. Me vendimin nr. 1624, datë 19.12.2007, Gjykata e Apelit Tiranë, në zbatim të detyrave dhe udhëzimeve të lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3064, datë 9.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. Me vendimin nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "Ndryshimin e vendimit nr. 1624, datë 19.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 3064, datë 9.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesëpadisë. Anulimin e akteve të marrjes së tokës në pronësi për sipërfaqet 2900 m² të të paditurit kundërpaditës Estref Avdillari, me nr. 315/69, datë 3.12.1999, dhe për sipërfaqen 4000 m² të të paditurit Enver Kurteshi, me nr.

315/72, datë 3.12.1999, që u përket akteve të marrjes së tokës në pronësi të vitit 1994. Deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik të kontratës së shitjes, të bërë ndërmjet të paditurit Enver Kurteshi dhe të paditurës Selvije Rushiti, për sipërfaqen prej 2000 m², me nr. 7301 rep., nr. 2087 kol., datë 8.12.1999, dhe fshirjen nga regjistri i pasurive të paluajtshme të akteve të mësipërme. Rrëzimin e kundërpadisë.”

11. Në vitin 2012, shtetasja Selvije Rushiti i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 38, datë 12.3.2013, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

II

12. Me kërkesën e datës 9.4.2013, **kërkuesit Enver Korteshi dhe Estref Avdillari** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke paraqitur këto shkaqe:

12.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e tij, të parashikuara në nenet 472 dhe 485 të KPC-së, pasi ka bërë interpretim të ndryshëm të fakteve të interpretuara nga gjykatat e tjera, duke dalë në një konkluzion krejt të kundërt me atë të gjykatës së apelit dhe të shkallës së parë. Në bazë të nenit 485 të KPC-së, ai mund të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së apelit apo ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, por nuk ka të drejtë që mbi bazën e rivlerësimit të provave të prishë vendimet dhe të rrëzojë kërkesëpadinë.

12.2 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me dy vendime të mëparshme ka prishur vendimet e gjykatës së apelit dhe e ka kthyer çështjen për rishqyrtim, duke i pranuar në këto gjykime provat dhe faktet ashtu si i kishin pranuar gjykatat më të ulëta dhe duke urdhëruar përsëritjen e hetimit gjyqësor. Në këto vendime ai është shprehur edhe lidhur me vijën e verdhë dhe regjimin juridik të tokës (vendimi nr. 51/2006 i Gjykatës së Lartë). Edhe pse këto detyra janë zbatuar nga gjykata e apelit dhe në përfundim të gjykimit është vendosur pranimi i kundërpadisë, Gjykata e Lartë anashkalon të gjitha argumentet juridike të përdorura nga gjykata e apelit dhe, mbi të gjitha, arsyeton në kundërshtim me vendimin e saj nr. 51/2006.

12.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e gjykimit të paanshëm dhe barazisë së armëve në gjykim, pasi në dy vendime të saj, nr. 51/2006 dhe nr. 536/2012, ka marrë pjesë në trupin gjyqësor, për më tepër si kryesues, gjyqtari B.I. Për më tepër, ky gjyqtar ka vendosur në mënyra të ndryshme në këto vendime.

12.4 Paanshmëria e gjyqtarëve nënkupton edhe se nuk duhet të ketë paragjykime për palët. Kërkuesit, duke qenë “romë”, janë ndjerë inferiorë përpara trupës gjyqësore të Kolegjit Civil, që ka mbajtur një qëndrim dukshëm të njëanshëm.

13. **Subjektet e interesuara, Fadil Duraku dhe Mustafa Shurdhi**, në parashtrimet e tyre drejtuar Gjykatës Kushtetuese, prapësojnë se:

13.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një interpretim të ndryshëm të fakteve, por mbi të njëjtat fakte të pranuar nga gjykata e apelit ka bërë interpretimin e ligjit. Në gjykatën e apelit është provuar se sipërfaqja e tokës objekt konflikti gjyqësor ka qenë brenda vijave kufizuese të qytetit në momentin që janë dhënë aktet e marrjes së tokës në pronësi, fakt ky i pranuar nga Gjykata e Lartë.

13.2 Fakti që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me dy vendime të tij e ka kthyer çështjen për rigjykim dhe ka dhënë udhëzime të ndryshme, nuk e bën vendimin e kundërshtuar jokushtetues, pasi vendimet që kthejnë çështjen për rigjykim nuk janë përfundimtare.

13.3 Nuk është i bazuar pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi në gjykimin në Gjykatën e Lartë kanë marrë pjesë pesë gjyqtarë, të cilët kanë qenë unanim me votimin lidhur me zbatimin e ligjit. Fakti që ai ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në vendimin e mëparshëm, nuk tregon njëanshmëri.

13.4 Në lidhje me pretendimin se gjykata ka qenë e njëanshme për shkak se kërkuesit janë romë, nuk ka asnjë fakt që të provojë një pretendim të tillë.



III Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

14. Përpara se të shprehet lidhur me thelbin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesit, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vëren se vendimi nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është bërë edhe më parë objekt i shqyrtimit nga kjo Gjykatë, e vënë në lëvizje në bazë të kërkesës së paraqitur nga shtetasja Selvije Rushiti, për të cilën Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, me vendimin nr. 38, datë 12.3.2013, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

15. Gjykata, në praktikën e saj, ka pranuar rishqyrtimin e kërkesave me të njëjtin objekt kur, brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, janë paraqitur shkaqe të reja për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 29, datë 21.12.2006; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kërkesën në shqyrtim, kërkuesit kanë ngritur përsëri pretendimin për cenimin e standardit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, por e kanë lidhur atë me faktin se Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me provat dhe faktet e pranuar dhe të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, pretendim i cili nuk ishte ngritur në kërkesën e paraqitur nga shtetasja Selvije Rushiti. Po ashtu, ata kanë paraqitur, si shkak të ri, cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Në kushtet kur këto pretendime nuk janë ngritur më parë para Gjykatës dhe në lidhje me to nuk është mbajtur një qëndrim përfundimtar, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 38, datë 12.3.2013 i kësaj Gjykate, nuk përbën pengesë në aspektin kushtetues për marrjen në shqyrtim të tyre.

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

16. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ajo ka bërë një interpretim të ndryshëm të fakteve të interpretuara nga gjykatat më të ulëta. Sipas tyre, pas zbatimit të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, gjykata e apelit, në interpretim të fakteve dhe provave të administruara, ka arritur në konkluzionin se duhej pranuar kundërpadia, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në kundërshtim me interpretimin e bërë nga gjykata e apelit dhe duke anashkaluar argumentet juridike të përdorura nga ajo gjykatë, ka arritur në një konkluzion të ndryshëm.

17. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj, nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile, kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në

kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se me vendimin nr. 51, datë 12.1.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka kthyer çështjen për rigjykim në gjykatën e apelit, duke përcaktuar detyra për atë gjykatë gjatë rigjykimit të çështjes, më konkretisht lidhur me përcaktimin e regjimit juridik të tokës dhe kuadrin ligjor në të cilin është trajtuar ajo. Në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, ka arsyetuar se toka objekt konflikti ka qenë tokë bujqësore dhe pra objekt i veprimit të ligjit për tokën dhe, në përfundim të gjykimin, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3064, datë 9.7.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka rrëzuar padinë dhe ka pranuar kundërpadinë.

21. Në bazë të rekursit të paraqitur nga subjektet e interesuara, kjo çështje është bërë përsëri objekt gjykimi në Gjykatën e Lartë, e cila përfundimisht, me vendimin nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 (vendimi i kundërshtuar), ka vendosur ndryshimin e vendimeve gjyqësore dhe pranimin e padisë. Duke qenë se për zgjidhjen e konfliktit gjyqësor ka qenë thelbësor përcaktimi i regjimit juridik të sipërfaqes objekt konflikti gjyqësor, i cili është trajtuar nga njëra anë me vendime të KKKP-së dhe nga ana tjetër me akte të marrjes së tokës në pronësi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në provat e administruara dhe të vlerësuara në gjykim, ka arritur në përfundimin se toka në fjalë është tokë truall dhe në këtë kuptim ajo i nënshtrohet rregullimeve të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, dhe jo atyre të ligjit për tokën. Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes që i njihen atij, duke e përqendruar vlerësimin e tij në përcaktimin e regjimit juridik të tokës në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993. Ai nuk rezulton të ketë marrë prova të reja apo të ketë bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë të gjykatave më të ulëta. Kjo gjykatë, duke pranuar të gjitha provat e administruara në gjykimin e faktit dhe pa i ndryshuar ato, i ka analizuar dhe vlerësuar në vështrim të dispozitave ligjore të zbatueshme, si dhe jurisprudencës së vetë asaj gjykate, duke konkluduar se gjykatat kanë bërë një interpretim të gabuar të ligjit dhe për këto arsye edhe ka shfuqizuar vendimet e gjykatave më të ulëta. Për sa i përket referimit që Gjykata e Lartë bën në vendimin nr. 1, datë 28.3.1995 të KNT-së në rreth, i cili ka konsideruar si të pavlefshme aktet e marrjes së tokës në pronësi në sipërfaqen e gjendur brenda vijës kufizuese të Bashkisë Tiranë, ajo rezulton të jetë, gjithashtu, një provë e administruar në dosjen gjyqësore dhe e vlerësuar më parë nga gjykatat e faktit (*shih vendimin nr. 1199, datë 27.10.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

22. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, është i pabazuar.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e paanshme

23. Kërkuesit pretendojnë edhe cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për shkak se në dy vendime të Gjykatës së Lartë, që i referohen kësaj çështjeje, në trupin gjykues ka marrë pjesë i njëjti gjyqtar B.I., i cili ka qenë në të dy rastet edhe kryesues i Kolegjit Civil. Po ashtu, sipas tyre, duke qenë “romë” ata janë ndjerë inferiorë përpara trupës gjyqësore të Kolegjit Civil, që ka mbajtur ndaj tyre një qëndrim dukshëm të njëanshëm.



24. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ- së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 38, datë 15.10.2007; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 11, datë 5.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale *pasiv* dhe *super partes* (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 204.2009; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim paanshmëria duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarit B.I., pra bindjes së brendshme të këtij gjyqtari për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, ndaj ajo prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është mjaftueshmërisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Lidhur me paanshmërinë objektive, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimin Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005*).

28. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 15, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata çmon se duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesit mbi njëanshmërinë e këtij gjyqtari, për shkak të pjesëmarrjes së tij në dy gjykime të zhvilluara në Gjykatën e Lartë, që lidhen me të njëjtën çështje, është i mjaftueshëm për të cenuar në themel drejtësinë e vendimit të marrë në mënyrë unanime nga një kolegji gjyqësor i përbërë nga pesë gjyqtarë.

29. Gjykata konstaton se me vendimin nr. 51, datë 12.1.2006, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, duke përcaktuar edhe disa detyra për

atë gjykatë. Në këtë vendim gjyqtari B.I., i cili ka mbajtur qëndrim paralel me shumicën, nuk ka shprehur mendim lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje, por ka vlerësuar se përcaktimi i natyrës juridike të tokës në konflikt është një çështje që i përket gjykatës së apelit dhe duhet të rezultojë nga përsëritja e shqyrtimit gjyqësor (*shih mendimin paralel të vendimit të Kolegjit Civil*). Në vendimin nr. 00-2012-2578 (536), datë 22.11.2012 (pasi çështja ishte rigjykuar në gjykatën e apelit) gjyqtarët në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kanë vendosur, me unanimitet, se sipërfaqja objekt konflikti, duke qenë tokë truall, duhej të rregullohej nga ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe jo nga ligji për tokën dhe, për pasojë, kanë vendosur pranimin e padisë. Ndërsa në gjykimin e parë gjyqtari B.I. është shprehur lidhur me detyrat që duhet të kryente gjykata e apelit gjatë rishqyrtimit të çështjes, në gjykimin e kundërshtuar, Kolegji Civil në të cilin ai ka marrë pjesë, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, e ka zgjidhur çështjen duke u ndalur në vlerësimin e mënyrës së zbatimit dhe të respektimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe nuk është shprehur mbi të njëjtat probleme të vëna në diskutim në gjykimin e mëparshëm. Për pasojë, fakti i thjeshtë që ky gjyqtar ka qenë pjesë e Kolegjit Civil, në të dy vendimmarrjet, nuk mjafton për të mbështetur objektivist dyshimet e kërkuësve, në kushtet kur ai nuk e kishte manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim dhe qëllimi dhe natyra e veprimeve që ka kryer gjatë procesit gjyqësor nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e tij.

30. Kërkuësit pretendojnë, gjithashtu, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur një qëndrim të njëanshëm, për shkak të faktit se ata janë “romë”. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata vlerëson se ai është haptazi i pabazuar, pasi kërkuësit nuk kanë paraqitur asnjë provë për ta mbështetur atë.

31. Në përfundim, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkuësve për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivist e paanshme në perceptimin e publikut, është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më datë 25.9.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha
Anëtar kundër: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 3, datë 23.1.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“
Fatos Lulo	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“



me sekretare Blerina Basha, në datën 08.11.2013 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr.37/10 Akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Arjan Lutaj, Piro Lutaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Mimoza Libohova, Veiz Jaupaj, Mira Manastiri, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Vlorë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve: nr.752, datë 24.03.2009 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.361, datë 28.09.2009 i Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.00-2011-792, datë 07.06.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 dhe 20 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; neni 6 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi pretendimet e palëve dhe aktet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në vitin 1992, me vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë, kërkuesit Piro Lutaj, efektiv ushtarak i repartit 1535, i është dhënë e drejta e banimit në objektet e ish- Policisë Ushtarake Vlorë, në pjesën veriore të saj, në një ambient të kthyer në banesë, të përbërë nga 2 dhoma dhe tualet.

2. Në vitin 1993 këto banesa janë kaluar në inventarin e Ndërmarrjes Banesa Vlorë dhe, në zbatim të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, po këtë vit, midis Ndërmarrjes Banesa dhe kërkuesit Piro Lutaj është lidhur një kontratë për privatizimin e banesës (apartament), të përbërë nga një dhomë e kuzhinë. Në momentin e privatizimit kërkuesi ka qenë i martuar me shtetasen K.L. Në vitin 1995, ky shtetas, së bashku me bashkëshorten (në cilësinë e bashkëpronarëve) ia kanë dhuruar këtë banesë kërkuesit Arjan Lutaj. Të gjitha veprimet e mësipërme lidhur me këtë pasuri janë regjistruar edhe në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

3. Në vitin 1996, zyra e urbanistikës pranë Bashkisë Vlorë ka pajisur kërkuesin Arjan Lutaj me leje për ndryshim destinacioni të objektit, nga shtëpi banimi në dyqan për artikuj të ndryshëm.

4. Subjekti i interesuar, Mimoza Libohova, është trashëgimtare e shtetasit SH.V., të cilit, me vendimin e ish-Komitetit Ekzekutiv të vitit 1945 i është sekuestruar pasuria, ku përfshihej dhe një garazh me dy magazina dhe oborr. Me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr.91, datë 12.12.1995, trashëgimlënësi SH.V. është njohur pronar mbi një banesë dykatëshe, një garazh me dy magazina dhe një oborr, si edhe mbi një sipërfaqe trualli prej 24.000 m², me kufizimet përkatëse. Në pikën 1/b të këtij vendimi, është vendosur që ish-pronarit t'i kthehet në natyrë godina dykatëshe dhe garazhi (me kufizimet sipas pikës 1/a të vendimit), kurse në pikën 1/c është vendosur kompensimi për sipërfaqen e truallit prej 5000 m².

5. Me urdhrin e vitit 2007 të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë, është urdhëruar korrigjimi i sipërfaqes ndërtimore në kartelën e pasurisë të bashkëpronarëve, trashëgimtarë të trashëgimlënësit SH.V., nga 172m² në 125m².

6. Shtetasja Mimoza Libohova, në cilësinë e bashkëpronares, i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt detyrimin e kërkuesve që t'u njohin pronarë dhe të lirojnë dhe dorëzojnë dy garazhe dhe një oborr me sipërfaqe 112 m², dhe konstatimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së privatizimit të banesës dhe asaj të dhurimit.

7. Me vendimin nr. 752, datë 24.03.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

"Pranimin pjesërisht të padisë së paditëses Mimoza Libohova. Detyrimin e të paditurve Arjan Lutaj dhe Piro Lutaj që të njohin si pronarë, si dhe t'u lirojnë trashëgimtarëve të ish-pronarit SH.V. një garazh me sipërfaqe 40.28 m² të ndodhur në..... Konstatimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së privatizimit të datës 21.12.1993, të lidhur ndërmjet të paditurit Piro Lutaj dhe ish-NKB Vlorë. Konstatimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së dhurimit të datës 07.08.1995, të lidhur ndërmjet

të paditurve Piro Lutaj dhe Arjan Lutaj. Çregjistrimin nga regjistrat e ZVRPP Vlorë të pasurisë me nr.54/99, të ndodhur në zonën kadastrale nr.8605 të qytetit Vlorë, pasuri kjo e cila figuron e regjistruar në emër të të paditurit Arjan Lutaj. Regjistrimin në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit SHV të objektit garazh me sipërfaqe 40.28 m² dhe të truallit poshtë tij të ndodhur në..... Rrëzimin e padisë së paditëses Mimoza Libohova për detyrimin e të paditurve Piro Lutaj dhe Arjan Lutaj që të njohin si pronarë dhe t'u lirojnë e dorëzojnë trashëgimtarëve të ish-pronarit SH.V. sipërfaqen e truallit prej 71.72 m². .. ”.

8. Me vendimin nr. 361, datë 28.09.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kërkuesit Piro dhe Arjan Lutaj.

9. Me vendimin nr.00-2011-792, datë 07.06.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

10. **Kërkuesit Piro Lutaj dhe Arjan Lutaj** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kundërshtuar vendimet e mësipërme gjyqësore dhe pretendojnë se procesi gjyqësor i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor për këto shkaqe:

10.1 Është cenuar e drejta e palëve për t'u dëgjuar në gjykim. Gjykatat kanë konstatuar absolutisht të pavlefshme një kontratë dhurimi, duke mos dëgjuar një prej palëve të saj, konkretisht dhuruesen K.L., bashkëshortja e kërkuesit Piro Lutaj. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që ajo të jetë thirrur si palë e paditur, por as si person i tretë, çka është atribut i gjykatës në bazë të nenit 193 të KPC-së. Formimi drejt i ndërgjyqësisë përbënte kusht të domosdoshëm për rregullsinë e procesit gjyqësor, pasi ai lidhet me parimin e kontradiktoritetit në gjykim dhe të barazisë së armëve.

10.2 Është cenuar parimi i sigurisë juridike. Pasuria objekt gjykimi është tjetërsuar në bazë të një kontrate nga një institucion shtetëror, duke arkëtuar edhe pagesën në mënyrë të rregullt.

10.3 Është cenuar e drejta për një proces të rregullt, pasi gjykatat nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm. Në gjykim nuk është lejuar paraqitja në cilësinë e provës e dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet të cilit provohet ligjshmëria e mënyrës së fitimit të pronësisë së banesës nga kërkuesit, si dhe nuk janë marrë në shqyrtim kontrata e qirasë për banesën dhe librezat përkatëse, për të cilat gjykata shprehet se mungojnë. Po ashtu, pozicioni i pronës, të cilit i janë referuar gjykatat e faktit, është i pavërtetë.

10.4 Është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë. Në rekurs është ngritur një çështje ligjore thelbësore, që lidhet me atë nëse plotësohen kushtet e padisë së rivendikimit, dhe në këto kushte Gjykata e Lartë duhet të pranonte rekursin për shqyrtim në seancë gjyqësore.

10.5 Është cenuar standardi i arsytimit të vendimeve gjyqësore, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa paraqitur arsyet për këtë qëndrim.

10.6 Është cenuar e drejta e pronës private, e sanksionuar në Kushtetutë, e fituar nëpërmjet një veprimi juridik të vlefshëm.

10.7 Është cenuar parimi i shtetit të së drejtës dhe i ndarjes së pushteteve. Gjykatat kanë marrë kompetenca që u takojnë organeve të administratës shtetërore, sepse sipërfaqja e tokës nën objekt nuk duhet të kthehet me vendim gjykate, por me vendim të KKKP-së. Gjykatat janë shprehur për të drejta pronësie që nuk janë kërkuar dhe nuk janë marrë më parë në shqyrtim nga organi administrativ.

11. **Subjekti i interesuar, Mimoza Libohova**, ka paraqitur këto prapësime përpara Gjykatës për të kundërshtuar pretendimet e kërkuesve:

11.1 Pretendimi për mosthirrjen në gjykim të shtetasës K.L. nuk mund të ngrihet nga kërkuesit, pasi ata mund të pretendojnë vetëm cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe nuk mund të mbrojnë të drejtat e individëve të tjerë.

11.2 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk është ngritur në gjykatat e zakonshme dhe, për këtë arsye, kërkuesit nuk i kanë shteruar mjetet ligjore.

11.3 Pretendimi për cenimin e të drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë është haptazi i pabazuar,



pasi është kompetencë e kolegjit të asaj gjykate të vendosë nëse plotësohen ose jo kushtet për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore.

11.4 Pretendimi për mosarsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar, pasi tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konsideruar se këto lloj vendimesh, pavarësisht formulimit të përmbledhur të pjesës arsyetuese, plotësojnë kërkesën për arsyetimin e tyre.

11.5 Pretendimi për cenimin e të drejtës së pronës nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

12. Kërkesit pretendojnë se për shkak të mosformimit drejt të ndërgjyqësisë, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të dhurueses tjetër të banesës objekt konflikti gjyqësor, është cenuar parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykim.

13. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr.19, datë 12.06.2003; nr.23, datë 08.06.2007; nr.34, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr.18, datë 23.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në jurisprudencën e Gjykatës, mosformimi i drejtë i ndërgjyqësisë është cilësuar si shkelje e standardeve për një proces të rregullt ligjor dhe është analizuar në funksion të cenimit të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, si dhe të barazisë së armëve, të cilat kërkojnë që në çështjet civile secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimet nr. 34, datë 25.07.2011; nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, rezulton se në procesin gjyqësor janë thirrur si palë e paditur në gjykim shtetasit Piro Lutaj dhe Arjan Lutaj, kurse shtetasja K.L., e cila ka pasur cilësinë e bashkëpronares së pasurisë objekt konflikti gjyqësor, si bashkëshorte e përfituesit të kontratës së privatizimit të banesës, nuk është thirrur as nga pala paditëse, në padi, dhe as nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit, edhe pse si objekt i gjykimit ka qenë, ndër të tjera, konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së privatizimit të banesës dhe asaj të dhurimit. Edhe pse thirrja e palëve të paditura në proces është lënë në disponibilitetin e paditësit, dispozitat procedurale ia kanë njohur edhe gjykatës këtë të drejtë, duke parashikuar në nenin 193 të KPC-së se ajo vetë, në rast se çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore.

16. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit

(komplementaritetit) (shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 19 datë 02.04.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.07.2013; nr. 52, datë 02.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese).

17. Nga materialet e çështjes konkrete në shqyrtim, rezulton se pretendimi për formimin drejt të ndërgjyqësisë është ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, si një nga shkaqet për cenimin e vendimmarrjes së gjykatave më të ulëta, si dhe gjen pasqyrim edhe në vendimin e asaj gjykate (të dhomës së këshillimit). Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm i të drejtës për një proces të rregullt.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë

18. Kërkesit pretendojnë cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa paraqitur arsytet për këtë qëndrim.

19. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr.20, datë 13.04.2012; nr.38, datë 30.12.2010; nr.36, datë 25.07.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr.25, datë 10.06.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsytimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr.3, datë 19.02.2013; nr.36, datë 25.07.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet në bazë të të cilave kërkesit kanë pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, që lidhen me shkelje procedurale, si edhe me mënyrën e zbatimit të ligjit material, më konkretisht atij për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe kuadrit ligjor për privatizimin e banesave. Edhe pse këto shkaqe përfshihen në parashikimet e nenit 472 të KPC-së dhe i përkasin kompetencës së shqyrtimit nga ajo gjykatë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e tij, duke mos dhënë asnjë argument për përfundimin e shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit.

23. Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivist nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në



funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n.19, datë 19.07.2005; nr.22, datë 06.06.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se, nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në recurs nga kërkuesit, mungesa e arsytimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një mangësi në përmbajtjen dhe në arsytimin e vendimit të asaj gjykate.

C. Lidhur me pretendimet e tjera

25. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që lidhen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur shterohen mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme (*shih vendimet nr.1, datë 25.01.2010; nr.36 datë 10.11.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga individit, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'i jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr.32, datë 28.12.2009; nr.6, datë 04.03.2010; nr.15, datë 19.04.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve që lidhen me cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe ato që kanë të bëjnë me moslejimin e paraqitjes në cilësinë e provës dhe mosmarrjen në shqyrtim të disa dokumenteve, nuk janë ngritur më parë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet ligjore, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Po ashtu, pretendimi për cenimin e të drejtës së pronës private, nuk mund të merret në shqyrtim, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, përderisa nuk shoqërohet me pretendime që lidhen me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për sa u përket pretendimit se gjykatat kanë marrë kompetenca që u takojnë organeve të administratës shtetërore, pasi sipërfaqja e tokës nën objekt duhej të kthehej me vendim të KKKP-së, Gjykata vlerëson se ky pretendim, në thelb, lidhet me çështje që i përkasin themelit (vlerësim provash dhe provueshmëri të pretendimeve të palëve) dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim në këtë gjykim kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.00-2011-792, datë 07.06.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vendosur më datë 8.10.2013

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, atëherë vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*prg. 23 i vendimit*). Bazuar në këtë qëndrim, shumica ka konkluduar se nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesit, mungesa e arsytimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) përbën një mangësi në përmbajtjen dhe arsytimin e vendimit të kësaj gjykate (*prg. 24 i vendimit*).

Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës pasi, në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkuesve në vendimin e saj, të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përdorur shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; 108, datë 03.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.05.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 07.12.2011, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsytuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*).

Për më tepër, vlerësojmë se standardi mbi të cilin mbështetet shumica në këtë çështje, nuk krijon garanci për ruajtjen e vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës dhe, për pasojë, lë hapësirë për cenimin e sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit. Këtë vlerësim e mbështesim në arsyet që vijnë.

Shumica nuk ka shpjeguar se cila është natyra e pretendimeve, të cilave, sipas saj, Gjykata e Lartë duhet t’u japë përgjigje të arsytuar edhe kur vendos mospranimin e rekursit, siç është rasti konkret. Nga arsytimi i saj nënkuptohet se, në rastin e ngritjes në rekurs të pretendimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet të japë argumente për përfundimin e shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit (*shih prg. 22-23*). Në një arsytim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime të natyrës kushtetuese, pra që kanë të bëjnë me shkelje të parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t’u japë përgjigje pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsytim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsytimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsytimit, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet përse arsytimi i kufizuar konsiderohet i rregullt, në aspektin kushtetues, në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

Nisur nga ky arsytim i shumicës, lind pyetja: nëse pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me shkelje të parimeve themelore të procesit gjyqësor, a duhet t’u japë përgjigje atyre edhe Gjykata e Kushtetuese? Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar natyrën e pretendimeve të ngritura në të dhe duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit është atribut i



Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs, në dhomë këshillimi. Ajo verifikon nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim dhe, sipas rastit, vendos pranimin ose mospranimin e rekursit. Siç është shprehur edhe shumica, e gjithë veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj (*shih vendimet nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 4, datë 25.02.2009; nr. 5, datë 26.01.2007 dhe nr. 8, datë 02.05.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Çojmë se vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton, midis të tjerave, edhe rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës. Gjykata është shprehur se është e pranueshme, në mënyrë të natyrshme, që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar rritjen e standardeve kushtetuese. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës Kushtetuese ose korrigjimi i doktrinës zyrtare kushtetuese mund të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme, sidomos për ta harmonizuar atë me praktikën e GJEDNJ-së (*shih vendimet nr. 20, datë 01.06.2011; nr. 30, datë 17.06.2010 dhe nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja, në këtë këndvështrim, është shprehur se: “Roli i një gjykate të lartë në një palë kontraktuese është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria. (...) Është në interes të sigurisë juridike, të parashikueshmërisë dhe të barazisë para ligjit që gjykata të mos shmanget pa motiv të vlefshëm nga precedentët.” (*Shih çështjen Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë, datë 23.03.2010, prg. 83 dhe çështjen Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 18.01.2001, prg. 70*). Në rastin konkret, shumica nuk e ka justifikuar ndryshimin e praktikës së Gjykatës me një motivim të qartë e të bazuar.

Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjykitimit në Gjykatën e Lartë. A mundet Gjykata ta kontrollojë përsëri nga pikëpamja kushtetuese të njëjtin vendim pasi çështja të jetë rigjykuar në Gjykatën e Lartë? Në rastin konkret shumica i është shmangur vlerësimit kushtetues të pretendimeve që, në çmuarjen e saj, kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çojmë se në rastin konkret nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesi duhej të ishte rrëzuar.

Anëtarë: Sokol Berberi, Fatos Lulo

URDHËR

Nr. 1, datë 7.1.2014

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj gjykate, z.Kujtim Osmani.

2. Kompetencat e titullarit të autoritetit kontraktor të Gjykatës Kushtetuese, do të ushtrohen për periudhën 7.1.2014 deri më 31.12.2014.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjitha strukturat e tjera përgjegjëse.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bashkim Dedja

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 24 lekë